

WASSERPROOF 2KF



PERSHKRIMI

Material bi-komponent, i bazuar në çimento, i cili ka veti elastike dhe përdoret për impermeabilizim.

KARAKTERISTIKAT

Hidroizolues dy-komponentësh me bazë çimento, inertesh me granulometri të seleksionuar, aditivësh specialë dhe polimere sintetike në dispersion ujor. Duke përzier dy komponentët, përftohet një masë që mund të aplikohet edhe në sipërfaqe vertikale, me një trashësi deri në 1 mm për shtresë. Falë përmbajtjes së lartë të rezinave sintetike dhe cilësive të tyre, ai garanton një ngjitje të shkëlqyer në të gjitha sipërfaqet e betonit, tullave dhe qeramikës (të parapërgatitura). Pas forcimit, ai krijon një shtresë hidroizoluese dhe elastike, rezistente ndaj agentëve atmosferikë.

FUSHA E ZBATIMIT

- Shtrimin e membranave hidroizoluese përpara vendosjes së pllakave për brenda dhe jashtë.
- Mbrojtje fleksibël dhe rezistente ndaj ujit e lagështisë për sipërfaqet e betonit dhe suvatë. Sa më i madh është presioni i ujit aq më i trashë duhet aplikuar produkti.
- Veshje hidroizoluese dhe mbrojtëse e sipërfaqeve të betonit, subjekt i agresionit kimik, si kripërat anti - ngricë, sulfatet, etj.
- Nivelim hidroizolues dhe elastik i suvave të plasaritura.
- Veshje hidroizoluese dhe mbrojtëse e mureve në themele.
- I përshtatshëm për hidroizolim të sipërfaqeve të cilat janë subjekt i vibrimeve dhe i deformimeve të ndryshme.
- Hidroizolim i pishinave me beton të maturuar (mbi 6 muaj)

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

	A	B
Pamja :	Pluhur	Lëng
Ngjyra:	Gri	Bardhë
Masa volumore:	1.5 gr/cm ³	1.1 gr/cm ³
Mbetje e thatë :	100%	50%
Djegshmëria:	I padjegshëm	
Ngjyra e përzierjes :	Gri	
Raporti i përzierjes :	25	8
Koha e punueshmërisë :	≥60 min	
Masa volumore e përzierjes :	1.7 gr/ cm ³	
Temperatura e aplikimit :	Nga +8°C deri në +30°C	
Trashësia max për dorë :	1 mm	
Koha midis duarve :	4-5 Hours	
Koha për shtrimin e pllakave :	24 Hours	

MËNYRA E APLIKIMIT

DysHEME çimentoze në ballkone, tarraca dhe pishina, sipërfaqja që do të izolohet duhet të ketë një pjerrësi të përshtatshme dhe nuk duhet të ketë gropa (gropat duhen të mbulohen me GP Repair). Në qoftë se suporti ka mbetje telash apo hekurash të cilat dalin nga thellësia e betonit apo murit atëherë ato duhen prerë në thellësi 2 - 4 cm dhe më pas gropën e hapur e mbulojmë me mënyrën e përshkruar më lart.

Sipërfaqja që do të trajtohet duhet të jetë plotësisht e pastër, rezistuese dhe e qëndrueshme. Për izolimin e bodrumeve në ndertësat e vjetra, duhet të hiqet çdo suvatim ekzistues deri në një lartësi prej 30 cm mbi nivelin e lagështisë dhe më pas të vazhdohet si më lart. Në rastin e mbivendosjes së pllakave mbi pllakat ekzistuese të qeramikës, sigurohuni që ato të jenë të ngjitura mirë; pastroni dhe përgatitni sipërfaqen e dyshemesë së vjetër me kujdes, fillimisht me një detergjent të përshtatshëm, dhe më pas me Fuga Shine. Suvatë duhet të jenë të maturuara (7 ditë për çdo cm trashësi) me ngjitje të përshtatshme në suport dhe rezistencë mekanike të mirë. Sipërfaqja që do të trajtohet duhet të jetë plotësisht e pastër dhe e qëndrueshme. Lagni me ujë sipërfaqen që do të izolohet, përpara se të aplikoni Wasserproof 2KF.

APLIKIMI

Derdhni komponentin B (lëngun) në një enë të pastër të përshtatshme; më pas, shtoni me ngadalë komponentin A (pluhurin) duke e përzier mekanikisht. Përziejeni me kujdes me një përzierës mekanik me shpejtësi të vogël, derisa të përftohet një masë homogjene. Nuk këshillohet përgatitja e përzierjes manualisht. APLIKIMI i materialit bëhet me furçë ose me rrul në disa duar në varesi të mbrojtjes që duam të sigurojmë ndaj ujit. Materiali aplikohet 1 mm për shtresë. Shtresa pasardhëse aplikohet mbasi të jetë tharë shtresa paraardhëse. Mbasi të keni aplikuar materialin duhet ta mbronit atë nga temperaturat e larta, shiu, etj. Në këndet lidhëse midis dyshemeve dhe mureve apo në sipërfaqet me shumë shtypje dhe mikroçarje etj, Wasserproof 2KF ka nevojë për përforsim duke mbuluar sipërfaqet me një shirit rrjetë me fibra 10 cm dhe nqs sipërfaqja është shumë difektoze atëherë të mbulohet komplet me rrjetë me fibra xhami nga 65 - 125 gr për m2. Gjithashtu rrjetë përdoret dhe për pishina apo tarraca.

PAKETIMI

Çanta letre 25 kg (komponenti A) dhe shishe plasti 8 kg (komponenti B).

RUAJTA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin e tij origjinal dhe të mbyllur, në zona të mbrojtura nga dielli dhe ngricat.

INFORMACION PËR SHËNDETIN DHE SIGURINË

Mbajeni jashtë arritjes së fëmijëve. Në rast kontakti me sytë ose gëlltitjeje, kërkoni këshillë mjekësore menjëherë dhe tregoni përmbajtjen e enës. Mos e hidhni produktin në kanalizime.

